

VENDIM
Nr. 146, datë 29.2.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR
BASHKËPUNIM KULTUROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim kulturor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**MBI BASHKËPUNIMIN KULTUROR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe qeveria e Shtetit të Katarit, e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, Arteve dhe Trashëgimisë, në vijim të referuara si “Palët”,

me dëshirën për të promovuar dhe zhvilluar bashkëpunimin reciprok midis dy vendeve në mënyrë miqësore, në fushën e kulturës, publikimeve dhe fushave të tjera të ngjashme,
bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Palët do të promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin kulturor midis dy vendeve të tyre nëpërmjet organizimit të javëve kulturore dhe ekspozitave të artit plastik ashtu si dhe shkëmbime të vizitave të grupeve muzikore, teatrore dhe artistike.

Neni 2

Palët do të shkëmbejnë informacion kulturor, foto dhe bookleta. Palët do të promovojnë gjithashtu bashkëpunimin midis bibliotekave kombëtare të të dyja vendeve. Për më tepër, Palët do të nxisin pjesëmarrjen e bibliotekave të tyre kombëtare dhe organizatave të lidhura me panairët e librit që do të mbahen në të dyja vendet.

Neni 3

Palët do të nxisin përkthimin e veprave të reja me çështje kulturore, artistike dhe letrare që mund të përçojnë kulturën e tyre në secilën gjuhë duke marrë në konsideratë të drejtat e autorit dhe rregullat e të

shkruarit sipas marrëveshjeve dhe ligjeve ndërkombëtare.

Neni 4

Të dyja palët do të mbështesin përpjekjet për bashkëpunim reciprok midis qendrave dhe institucioneve të ndryshme rinore në të dyja vendet si më poshtë:

- shkëmbimin e informacionit, kërkimeve dhe studimeve që lidhen me punën për rininë;
- shkëmbimin e ftesave për të marrë pjesë në evenimente ndërkombëtare rinore të organizuara në secilin vend;
- shkëmbimin e vizitave të të rinjve në të dyja vendet për të vendosur bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe për të realizuar rritjen e njohurive.

Neni 5

Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët për të zbatuar nenet e kësaj marrëveshjeje, duke ekzaminuar ndonjë çështje që mund të dalë gjatë implementimit, ashtu si dhe të përfundohen programet periodike bilaterale të bashkëpunimit kulturor.

Neni 6

Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit për delegacionin e saj. Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e akomodimit, transportin lokal, rastet e kurimit mjekësor, emergjent, mbi bazën e rregullave në fuqi për këtë çështje.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që lind midis palëve për interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit midis tyre.

Neni 8

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje apo pjesë të tekstit të saj mund të amendohen pas një miratimi me shkrim të të dyja palëve duke marrë parasysh procedurat ligjore të miratuara në të dyja vendet.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën që palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi dhe do të mbetet e vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh, e rinovueshme në mënyrë automatike për periudhë/periudha të njëjta kohore, përveç kur njëra prej palëve i jep fund përmes një njoftimi me shkrim, të paktën tre (3) muaj para përfundimit ose datës së mbarimit të saj, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të prekë asnjë program apo aktivitet ekzistues apo në vazhdim, përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

Në prani të dëshmitarëve, me anë të kësaj, të dy përfaqësuesit e autorizuar të qeverive palë nënshkruajnë këtë marrëveshje me autorizim të qeverive të tyre.

Bërë dhe nënshkruar në Tiranë më 18 tetor 2011, në dy kopje origjinale, duke qenë njëloj autentike në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht. Në rast mospërputhjeje në interpretim, do të mbizotërojnë teksti në gjuhën angleze.